



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.69 dt.15.05.1997

PER

**MIRATIMIN E FONDIT TE NEVOJSHEM PER RUAJTJEN E DISA
OBJEKTEVE TE BASHKISE TIRANE ME POLICI PRIVATE**

Këshilli i Bashkisë Tiranë, i mbledhur sot me dt.15.05.1997, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Organizim Personelit dhe Shërbimeve, nisur edhe nga situata e gjendjes së jashtëzakonshme në të cilën ndodhemi, për marrjen e masave të ruajtjes së objekteve të Bashkisë Tiranë me roje të policisë private,

VENDOSI

1. Të miratojë fondin e kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Organizim Personelit dhe Shërbimeve për ruajtjen e dy objekteve të Bashkisë Tiranë, godinën e Drejtorisë së Përgjithshme të Urbanistikës dhe Arshivën Linzë me anë të firmave të policisë private “Ismail Geci” dhe “Bardhi”, të cilët i kanë ruajtur këto objekte edhe pas përfundimit të kontratës së lidhur nga Bashkia Tiranë me këto dy firma.
2. Paga të likujdohet që nga momenti i përfundimit të kontratës e deri në shpalljen e firmave të reja fituese sipas tenderave që do të kryhen përkatësisht për shumat 86.895 lekë për firmën “Bardhi” dhe 78.400 lekë për firmën “Ismail Geci”. Likujdimi të bëhet sipas tarifave mujore të përcaktuara në kontratat e lidhura me këto firma me Bashkinë e Tiranës për ruajtjen e objekteve të mësipërme, duke marrë parasysh edhe mundësitë financiare që ka Bashkia për likujdimin e shumave të prapambetura.
3. Të miratojë fondin e nevojshëm për hapjen e tenderave për ruajtjen e dy objekteve të mësipërme, duke marrë parasysh si cmim tavan çmimin dysHEME të përcaktuar për dy firmat e mëparëshme fituese si dhe luhatjet e tregut brenda këtyre çmimeve në kërkesë – ofertë.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Personel Organizimit dhe Shërbimeve të organizojë tenderin për ruajtjen e objekteve të Bashkisë me polici private

sipas të gjitha rregullave ligjore, menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Kryesia e Bashkisë Tiranë të marrë të gjitha masat për vënien para përgjegjësisë të personave përgjegjës që kanë neglizhuar në zbatimin e procedurave ligjore për kryerjen në afatet kohore të tenderave për ruajtjen e objekteve të Bashkisë me polici private, të analizojë shkaqet dhe të raportojë në Këshillin e Bashkisë për masat e marra që të mos pësëriten me raste të tilla.
6. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi Kryesia e Bashkisë të Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme e Personel Organizimit dhe Shërbimeve dhe Drejtoria e Financës.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI